



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 26, Datë 22.02.2024

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN JANAR 2024 PËR KLIENTËT
E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.02.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 579/3 prot., datë 20.02.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Janar 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

- FSHU sh.a me shkresën nr. 643 prot., datë 01.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 579 prot., datë 05.02.2024, përcolli në ERE kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të muajit janar 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Referuar aplikimit të sipërcituar, shoqëria FSHU sh.a., për muajin janar 2024 e ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).
- ERE me shkresën nr. 579/1 prot., datë 16.02.2024, i ka kërkuar shoqërisë FSHU sh.a. të paraqesë profilet e blerjes në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike ALPEX sh.a. për sasinë e energjisë elektrike të siguruar për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF për periudhën e furnizimit si dhe përllëgaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike duke u bazuar në këto profile.
- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 1002/1 prot., datë 19.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 579/2 prot., datë 19.02.2024, ka përcjellë aplikimin e korigjuar sipas kërkesave të paraqitura nga ERE.

- Mbështetur në nenin 8 të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, miratuar me vendimin nr. 201 të bordit të ERE-s, datë 04.12.2017, e ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Janar 2024 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
- Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, i cili la në fuqi vendimin e bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, kostot administrative të përlllogaritura për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike vijnë të mbeten në vlerën 1.06 lekë/kWh.
- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022 – 31 Dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.04.2022, është 0.85 lekë/kWh.
- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.
- Kursi zyrtar i këmbimit i publikuar nga Banka e Shqipërisë Lekë/Euro, i cili për përlllogaritjet e muajit janar 2024 konsiderohet ai i datës 31.01.2024.
- Në zbatim të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Janar 2024, përlllogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin janar 2024</i>			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	10.04
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.30
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh	13.80

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 13.80 Lekë/kWh për muajin Janar 2024.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin muajin Janar 2024 prej 13.80 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI